



“Meridian Express” shpall konkurs për plotësimin e vendit të punës:

Auditor/e i/e Brendshëm

Përgjegjësitë kryesore:

- Përkujdeset për hartimin e strategjisë, planit dhe procedurave të Departamentit të Auditimit të Brendshëm;
- Përgatit, planifikon dhe kryen auditime të brendshme të aktiviteteve të zhvilluara në filiale dhe departamente sipas planit të aprovuar, politikës, procedurave dhe standardeve të auditimit;
- Kryen kontrole me qëllim të rishikimit të zbatueshmërisë së politikave dhe procedurave të brendshme në fusha dhe procese të ndryshme të kompanisë;
- Kryen auditime, përfshirë intervista hyrëse me funksionet që auditohen, analizon dokumentacionin përkatës dhe regjistron të gjeturat;
- Analizon të dhënat financiare, të dhënat jo-financiare dhe proceset në kuadër të gjithë kompanisë me qëllim të identifikimit të rreziqeve të ndryshme dhe parregullsive tjera;
- Përgatit draft raportin, e diskuton me mbikëqyrësin dhe bën intervistën përfundimtare;
- Prezanton rezultatet e auditimit të kryer dhe jep rekomandimet rreth veprimeve që duhet ndërmarrë për përmirësimin e praktikave të punës kur ato janë të pazbatueshme ose nevojiten ndryshime;
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga raportet e mëparshme të auditimit;
- Kontrollon dhe vlerëson proceset, operacionet dhe sistemet e menaxhimit të informacionit financiar në aspekt të kontrollit, efikasitetit dhe parametrave tjerë;
- Rishikon aktivitetet dhe sistemet e kompanisë për të u siguruar se janë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe procedurat e brendshme, si dhe me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të tyre;
- Kontrollon saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të kontabilitetit dhe raporteve financiare sipas standardeve dhe për qëllime të autoriteteve të jashtme;
- Kryen kontrole dhe sigurohet për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit ;
- Siguron mbështetje të nevojshme gjatë kontrolleve të jashtme nga ATK, auditorët e jashtëm apo palë të tjera;
- Përpilon raportet për auditimet e kryera dhe përkujdeset për të siguruar evidencë dhe dokumentacion të mjaftueshëm mbështetës lidhur me të gjeturat gjatë auditimit;

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë universitare në Ekonomi;
- Kualifikim profesional në Kontabilitet apo Auditim (SCAAK, ACCA apo ndonjë shoqatë tjetër);
- Minimum tri (3) vite përvojë pune në fushën auditimit;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe prezantuese;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;

- Aftësi të mira të punës në ekip si dhe në mënyrë të pavarur;
- Aftësi të mira të komunikimit në gjuhën shqipe dhe angleze;
- Aftësi të mira të përdorimit të pajisjeve kompjuterike, në aplikacionet e MS Office dhe bazave të të dhënave tjera;

Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë duke dërguar CV-në në apliko@meridianexpress.com dhe duke cekur në subjekt qartë pozitën për të cilën aplikojnë.

Data e fundit për aplikim është data **15 Prill 2019**.

